



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
NR. PROT. 1072
DATE 4. 8. 2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1485/7 Prot.

Tiranë, më 31.07.2025

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për “Auditimin Financiar dhe të Përputhshmërisë”

Drejtuar: SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

TIRANË

Nga auditimi i ushtruar në subjektin Shkolla e Magjistraturës, në bazë të programit të auditimit nr. 1495/1, datë 24.12.2024, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për veprimtarinë nga data 01.01.2022 deri më datën 31.12.2024, u konstatua se veprimtaria e subjektit të audituar përgjithësisht është në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës, por rezultuan të pranishme dhe disa mangësi dhe problematika, të cilat janë trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bashkëlidhur kësaj shkrese.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe Vendimin nr. 117, datë 30.07.2025, të Kryetarit të KLSH-së, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

a- Opinion mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqiten në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2024, referuar kuadrin rregullator në fuqi: Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, ligjit “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit, etj.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një **opinion të pakualifikuar**¹ për llogaritë vjetore të vitit 2024 të subjektit Shkolla e Magjistraturës, pasi veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike.

b- Opinion mbi përputhshmërinë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Shkolla e Magjistraturës Tiranë, për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2024, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimit të sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimit të integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit Shkolla e Magjistraturës, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të kualifikuar**², e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinion:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë. Nga evidencat e marra për veprimtarinë e Shkollës së Magjistraturës, rezultuan:

- Mësimdhënia e normuar vjetore në programin e formimit fillestar dhe vazhdues për personelin akademik me kohë të plotë është realizuar në masën 33% të ngarkesës mësimore, ndërsa, për personelin akademik me kohë të pjesshme në masën 65%. Shpërndarja e orëve mësimore në raportin 35% personel akademik i brendshëm dhe 65% personel akademik i jashtëm, përbën kosto shtesë për buxhetin e Shkollës së Magjistraturës, në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25/2017;

- SHM si institucion i pavarur, nuk ka paraqitur në MFE referencën ligjore për trajtimin financiar të organeve kolegjiale drejtuese të saj, sipas përcaktimeve të pikës 5, neni 8 të ligjit nr. 35, datë 25.05.2023;

- Struktura organizative aktuale e Shkollës së Magjistraturës, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 48, datë 28.12.2015, i ndryshuar, nuk përputhet me kërkesat e ligjit nr. 115/2016 "Për

¹ Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar", të Kryetarit të KLSH-së (2022, fq.54), Kapitulli VII, pika 7.4.1: "Opinionit i pa kualifikuar/pamodifikuar: Audituesi duhet të shprehë një opinion të pamodifikuar për besueshmërinë e llogarive kur arrin në përfundimin se llogaritë vjetore janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me komizen e zbatueshme të raportimit financiar. Në mënyrë që të formojë këtë opinion, audituesi duhet të konkludojë se ka marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit."

² Opinion i modifikuar/ kualifikuar: Referuar Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-së (vendim nr. 24, datë 29.12.2022 fq.104) Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura".

organizimin dhe funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë”;

- Shkolla e Magjistraturës ka hedhur në HRMIS të dhënat për punonjësit më status nëpunësi civil dhe me kod pune. Personi i ngarkuar me hedhjen e të dhënave, nuk ka mundur të hedhë në këtë sistem të dhënat për personelin akademik që gëzon statusin e gjyqtarit, kërkesë e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përmbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”

- Nga auditimi mbi kryerjen e procesit të inventarizimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i aktiveve, rezultoi se, janë kryer asgjësime në landfill, edhe për artikujt elektronikë, të cilët duhet të ricikloheshin, pasi këto pajisje klasifikohen me kod 20 01 35 “mbetje te rrezikshme” për shëndetin dhe mjedisin, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”;

- Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël u konstatua se, për mallra/grup mallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta, janë parashikuar dhe kryer procedura me copëzim të fondit të prokurimit me vlerë të vogël, gjithsej në 24 raste, në shumën 7,977 mijë lekë, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 56, pika 1, 2,7 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 7 dhe pikat 11-12;

- Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës në llogarinë ekonomike 602 “Shpenzime operative”, u konstatuan efekte negative në përdorimin i fondeve buxhetore në shumën 1,343 mijë lekë.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin akademik 2023-2024, mësimdhënia e normuar vjetore në programin e formimit fillestar dhe vazhdues për personelin akademik me kohë të plotë u realizua 1820 orë e konvertuar, ose u realizua 33% e ngarkesës mësimore. Ndërsa, për personelin akademik me kohë të pjesshme u realizua **3318 orë të konvertuara, ose realizuar 65%**.

Shpërndarja e orëve mësimore në raportin 35% personel akademik i brendshëm dhe 65% personel akademik i jashtëm, **përbën kosto shtese** për buxhetin e shkollës së magjistraturës, veprim në mospërputhje me nenin 12.b të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 25/2017, sipas të cilit **mësimdhënia e normuar vjetore për stafin pedagogjik me kohë të plotë në formimin fillestar duhet të jetë 60 % të ngarkesës vjetore të lëndës vetëm për lëndët kryesore, si dhe nenit 12.a të VKD 25/2017, sipas të cilit mësimdhënia e normuar vjetore për stafin pedagogjik me kohë të pjesshme në formimin fillestar duhet të jetë jo më shumë se 40 % e ngarkesës vjetore të lëndës vetëm për lëndët kryesore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

1.1. Rekomandimi: Drejtori në bashkëpunim me Kancelarin dhe Sektorin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës të rishikojnë dhe ristrukturojnë shpërndarjen e ngarkesës mësimore ndërmjet personelit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme dhe të paraqitet për vendimmarrje në Këshillin Drejtues. Të zhvillohet një plan veprimi për rritjen e kapaciteteve të stafit të brendshëm për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të minimizuar varësinë nga personeli i jashtëm.

-Shkolla e Magjistraturës të ndërmarrë masa për të siguruar në vijim që personeli akademik me kohë të plotë gradualisht të mbulojë të paktën 60% të ngarkesës vjetore për lëndët kryesore në programin e formimit fillestar. Njëkohësisht, të bashkërendohet puna për të kufizuar kontributin e personelit me kohë të pjesshme, në jo më shumë se 40% të ngarkesës vjetore për të njëjtat lëndë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Shkolla e Magjistraturës, si institucion i pavarur nuk ka përmbushur detyrimin ligjor që të paraqesë në Ministrinë e Financave referencën ligjore për trajtimin financiar të organeve kolegjiale drejtuese të saj, sipas përcaktimeve të pikës 5, neni 8 të ligjit nr. 35, datë 25.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtori dhe Kancelari i Shkollës së Magjistraturës të marrin masa për të paraqitur në Ministrinë e Financave dokumentacionin me relacionin shoqërues, që përmban referencën ligjore dhe vendimmarrjen mbi trajtimin financiar të organeve drejtuese kolegjiale të saj, në përputhje me kompetencat e përcaktuara për institucionet e pavarura të sistemit të drejtësisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, në nenet 66/1; 66/2 dhe 66/3 është përcaktuar funksioni i Departamentit të Formimit Fillestar, Departamentit të Formimit Vazhdues dhe Departamenti i Kërkimeve Shkencore dhe Botimeve. Në Aneksin 14 “Përshkrimet e Punës” është përcaktuar pozicioni përgjegjës i formimit fillestar/vazhdues, njëkohësisht edhe pedagog i brendshëm. Pozicioni i përgjegjës të formimit fillestar/vazhdues është kërkesë e ligjit nr. 115/ 2016, neni 247, pika 1, germa “gj”, sipas të cilit në përbërjen e anëtarësisë së Këshillit Drejtues të Shkollës përfshihen edhe “përgjegjës të trajnimit fillestar dhe vazhdues”.

Struktura organizative aktuale e Shkollës së Magjistraturës, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 48, datë 28.12.2015, i ndryshuar, nuk përmban funksionin e Përgjegjës të Departamentit të Formimit Fillestar dhe Vazhdues, e materializuar si pozicion pune në Rregulloren e Brendshme, miratuar me Vendim të KD nr. 1, datë 31.01.2017, ndryshuar (shtuar) me Vendimin e KD nr. 3, datë 26.1.2023.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Shkollës së Magjistraturës të paraqesë në Këshillin Drejtues propozimin për rishikimin dhe përditësimin e strukturën organizative të institucionit, duke përfshirë në mënyrë të detajuar funksionet e Përgjegjës të Formimit Fillestar dhe të Formimit Vazhdues, si pozicione të veçanta dhe të materializuara në strukturën formale të shkollës, si dhe të marrë masa për përfshirjen e tyre në rregulloren e brendshme.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Shkolla e Magjistraturës për vitin 2022 ka patur në strukturë 4 (katër) vende vakante, përkatësisht 2(dy) pedagogë të brendshëm; 1(një) përgjegjës të sektorit të formimit vazhdues dhe 1 (një) këshilltar për botimet dhe publikimet shkencore. Gjithashtu edhe për vitin 2023 ka patur në strukturë 4 vende vakante, përkatësisht 1 (një) përgjegjës të sektorit të formimit vazhdues dhe 3 (tre) pedagogë të brendshëm. Për vitin 2024 ka patur vakanca për 6 vende, përkatësisht 1 (një) përgjegjës të sektorit të formimit vazhdues; 1 (një) sekretar titullari; 1(një) sekretar shkencore për formimin vazhdues, 1(një) sekretar shkencore për formimin fillestar dhe 3 (tre) pedagogë të brendshëm, duke sjellë ndarje të pa qartë të detyrave, mundësinë e përqendrimit të përgjegjësi e konfliktit të interesit, si dhe duke rritur riskun e mos realizimit të objektivave të Shkollës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Shkollës së Magjistraturës të marrë masa për plotësimin e strukturës me stafin akademik dhe administrativ me qëllim realizimin e objektivave të synuara.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatim të VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrin Qendror të Personelit”, Shkolla e Magjistraturës ka hedhur në HRMIS të dhënat për punonjësit me status nëpunësi civil dhe me kod pune. Personi i ngarkuar me hedhjen e të dhënave, nuk ka mundur të hedhë në këtë sistem të dhënat për personelin akademik që gëzon statusin e gjyqtarit, problematikë për të cilën ka njoftuar Departamentin e Administratës Publike, i cili krijon dhe administron Regjistrin Qendror të Personelit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Kancelari i Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike (DAP), të vijojë përpjekjet për zgjidhjen teknike dhe institucionale të problematikës së regjistrimit në HRMIS të personelit akademik me status gjyqtari.

-Të kërkohet nga DAP ofrimi i një zgjidhjeje të përshtatshme për përfshirjen e këtij grupi në sistem, duke garantuar trajtimin e barabartë dhe të unifikuar të të gjithë punonjësve të përfshirë në sistemin e shërbimit civil apo në funksione të lidhura.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit rezultoi se, dokumentacioni i administruar në to është plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe Rregullores së Brendshme të Shkollës, por ky dokumentacion ka nevojë për përditësim, kryesisht në lidhje me certifikatat personale të gjendjes civile, ose me çdo dokument tjetër, i cili mund të jetë ndryshuar gjatë periudhës së punësimit në institucion, bazuar në kërkesat e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për Rregullat e Hollësishme për Përbajtjen, Procedurën dhe Administrimin e Dosjeve të Personelit e të Regjistrin Qendror të Personelit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve i Shkollës së Magjistraturës, të ndërmarrë një proces periodik verifikimi dhe përditësimi të dosjeve të personelit, me qëllim pasqyrimin korrekt të çdo ndryshimi të ndodhur gjatë periudhës së punësimit, përfshirë certifikatat e gjendjes civile, ndryshime në gjendjen familjare, adresën e banimit apo dokumente të tjera relevante.

-Të përditësohet Rregullorja e Brendshme e Shkollës lidhur me menaxhimin e dosjeve të personelit, ku të përcaktohen qartë afatet dhe përgjegjësitë për përditësimin e dokumentacionit, si dhe detyrimi i punonjësve për të njoftuar ndryshimet e të dhënave personale brenda një afati të arsyeshëm.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Me Urdhrin e Brendshëm të Drejtorit të SHM nr. 249/2024 “Për pagesën e orëve shtesë për vitin 2024” është urdhëruar pagesa e orëve shtesë për punonjësit e administratës për vitin 2024, bazuar në prezencën e punonjësve dhe relacionet përkatëse për ditët dhe kohëzgjatjen e punës jashtë orarit zyrtar.

Nga auditimi rezultoi se për të punësuarit, që kryen veprimtari operacionale, për orët shtesë në punë, plotësohet kriteri i disponimit të fondeve për kompensimin financiar brenda buxhetit të miratuar të institucionit, plotësohet kushti i veprimtarisë së punonjësve të cilët kanë punuar jashtë orarit zyrtar si veprimtari operacionale jo më shumë se 200 orë në vit, por nuk plotësohet kushti i pamundësisë së institucionit për të kompensuar orët shtesë me ditë pushimi me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25 (njëzet e pesë) për qind të tyre kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune; apo orë shtesë plus 50 (pesëdhjetë) për qind të tyre kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste, në kundërshtim me kërkesat e pikën 9 të VKM nr. 568/2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e

administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me Kancelarin të marrin masa përpara se të autorizojë pagesën për orët shtesë, për të verifikuar paraprakisht mundësinë e kompensimit të këtyre orëve me ditë pushimi të barabartë, plus përqindjen përkatëse (25% për ditë të zakonshme pune dhe 50% për ditë pushimi/feste) si dhe të përditësohen procedurat e brendshme mbi mënyrën e menaxhimit, dokumentimit dhe verifikimit të orëve shtesë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore rezultoi se: Shkolla e Magjistraturës për periudhën objekt auditimi ka kryer shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me palë kandidatët për magjistratë. Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore janë kryer shpenzime përmbare më të shumta në shumën 1,101,330 lekë, përkatësisht në vitin 2023 në shumën 656,126 lekë dhe në vitin 2024 në shumën 445,204 lekë, duke sjellë një efekt negativ në buxhetin e Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, konstatohet se për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2022 deri 31.12.2024, janë ngritur 11 çështje gjyqësore, ku në paditë e ngritura nga kandidatët për magjistratë, paditësit kanë kërkuar shfuqizim të aktit administrativ të Komisionit të Disiplinës pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas vendimmarrjeve përkatëse. Gjykata, nga 11 çështje gjyqësore ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes në 3 çështje, për të cilat SHM ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë; pranimin e padisë për 1 çështje, për të cilën SHM nuk ka të drejtën e ankimit, pasi vendimi është i formës së prerë (vlera e padisë) sipas ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; 7 çështjet e tjera janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë, Tiranë. Nga ecuria e çështjeve gjyqësore, pavarësisht se gjykimi në themel i tyre nuk ka përfunduar, tregon se ekziston risku i nxjerrjes së aktit administrativ në kundërshtim me ligjin, duke rritur riskun e mundësisë së lindjes së detyrimeve të reja në të ardhmen, të cilat përbëjnë kosto shtesë për institucionin.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 27-59 dhe pikën 4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtori dhe Kancelari i Shkollës së Magjistraturës, nëpërmjet strukturave të brendshme saj të marrin masat për krijimin e kushteve të favorshme që linjat e raportimit mes sektorëve të garantojnë njoftimin e menjëhershëm të Sektorit të Financës në momentin e protokollimit të një vendimi në institucion, si dhe publikimin e grafikut të shlyerjes së detyrimeve në web-n e shkollës, me qëllim shmangien e tarifave përmbare më të shumta që shoqërohen me efekte në buxhetin e institucionit.

- Të konsolidohen mekanizmat e vlerësimit ligjor dhe riskut të akteve administrative para nxjerrjes së tyre, duke garantuar që çdo akt të jetë i mbështetur në dispozita të qarta ligjore dhe praktika administrative. Të hartohen raporte periodike risku, që analizojnë ecurinë e çështjeve gjyqësore në proces dhe ndikimin e mundshëm financiar në rast se vendimet do të jenë të pafavorshme për institucionin.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, në postin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, në llogarinë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” përfshihet dhe vlera e rikonstruksionit të ndërtesës në shumën 2,380,298 lekë kryer në vitin 2020, para periudhës së auditimit. Vlera e rikonstruksionit të objektit është kryer nga Shkolla e Magjistraturës dhe mbahet në këtë llogari, pavarësisht se objekti ku ushtron aktivitetin shkolla është në hua përdorje të saj,

bazuar në Kontratën e Hua Përdorje nr. 499, datë 17.07.2020 të Shkollës së Magjistraturës dhe nr. 250, datë 14.07.2020 të Ndërmarrjes Industriale Nr. 1, Tiranë, pasi objekti “Poli i Drejtësisë” me VKM nr. 356, datë 26.02.2020 është në përgjegjësi administrimi të kësaj ndërmarrje. Referuar kësaj VKM-je është në përgjegjësi të Ndërmarrjes Industriale Nr. 1, Tiranë, rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e objektit, e për rrjedhojë ky investim nuk duhej të kryhej nga shkolla dhe më së paku duhet të ishte transferuar pranë kësaj ndërmarrje, me qëllim evidentimin nga ana e saj në kontabilitet dhe përllogaritjen e amortizimit, pavarësisht nga kërkesat e vazhdueshme të SHM për transferimin e investimit

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtori dhe Kancelari i Shkollës së Magjistraturës në koordinim me Ndërmarrjen Industriale Nr. 1, Tiranë, të realizojnë sistemimet për transferimin e vlerës së investimit në objektin “Poli i Drejtësisë”, për evidentimin e saktë të vlerës së tij në evidencën kontabël të ndërmarrjes, si dhe përllogaritjen e amortizimit të aktivitetit.

Brenda vitit 2025

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kryerjen e procesit të inventarizimit dhe nxjerrjes nga përdorimi i aktiveve, rezultoi se, komisioni i nxjerrjes nga përdorimi të aktiveve në të tre vitet periudhë auditimi, kanë kryer asgjësimin e aktiveve në Landfillin e Sharrës, me anë të thyerjes, evidentuar në procesverbalin përkatës, kjo edhe për artikujt elektronikë, të cilët duhet të ricikloheshin. Nxjerrja nga përdorimi e pajisjeve kompjuterike duke u thyer dhe hedhur në vendgrumbullim mbeturinash bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, ku këto pajisje klasifikohen me kod 20 01 35 “Mbetje të rrezikshme” për shëndetin dhe mjedisin, pasi këto aktive duhej të ishin ricikluar. Gjithashtu, për nxjerrjen nga përdorimi të këtyre aktiveve SHM duhet të kishte zhvilluar ankand referuar Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve”, pika 109. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Kancelari i Shkollës së Magjistraturës në bashkëpunim me Sektorin e Financës dhe me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të marrin masa për kryerjen e ankandeve në rastet e nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi për përfitimin e vlerës së mbetur të tyre, e njëkohësisht mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit në rastet e aktiveve të klasifikuara si “Mbetje të rrezikshme”.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël u konstatua se, për mallra/grup mallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta, janë parashikuar dhe kryer procedura me copëzim të fondit të prokurimi me vlerë të vogël, konkretisht: gjatë vitit 2022 në 8 raste, me vlerë 2,929 mijë lekë, në vitin 2023 në 10 raste, me vlerë 3,274 mijë lekë dhe në vitin 2024 në 6 raste, në vlerën 1,773 mijë lekë, gjithsej në 24 raste, në shumën 7,977 mijë lekë, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 56, pika 1, 2,7 dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar, pika 7 dhe pikat 11-12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Kancelari në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrin masa që përgjatë hartimit të regjistrit të parashikimeve të prokurimeve të shmangen rastet e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve fizike të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2022 deri me 31.12.2022 rezultoi se dosjet fizike nuk janë të arkivuara në arkivin e Shkollës së Magjistraturës, por mbahen në zyrën e financës në përfundim të procesit të prokurimit, në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 11, pika 2, neni 15, pika 1/2, si dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat në RSH”, i ndryshuar, me “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH”, si dhe me Rregulloren nr. 95, datë 21.05.2024 “Për gjurmën e auditimit në Shkollën e Magjistraturës”, neni 73, germa a, b, c, d, e, f, g.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të marrë masa për arkivimin e dosjeve për të cilat janë përfunduar procedurat përkatëse, pranë arkivit të Shkollës së Magjistraturës konform kërkesave të akteve ligjore e nënligjore, me qëllim shmangien e risqeve të tjetërsimit dhe/ose humbjes së dokumentacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve u konstatua se, në tre raste, dokumentacioni i OE fitues në dosjen e prokurimit nuk ishte origjinal, veprime në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për organizimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74, pika 3, germa gj) dhe Rregullores nr. 95, datë 21.05.2024 “Për gjurmën e auditimit në Shkollën e Magjistraturës”, nenit 73, germa u).

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Kancelari në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të marrin masa që dokumentacioni i dosjes së procedurës së prokurimit i OE fitues të jetë origjinal ose i noterizuar, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit të zhvilluar në vitin 2022, me objekt “Blerje pajisje elektronike”, rezultoi se AK ka kryer modifikimin e kriterëve kualifikues të përcaktuara në DT, duke hequr kriterin kualifikues për “Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001”, veprim në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 2, pikat 2, 3, 23/b/ç, nenet 36, 39 dhe 42, 77, pika 1/a/b/c dhe pika 4, dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për organizimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 40, pika 3 dhe pika 5/a/b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 73-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrë të gjithë masat e nevojshme me qëllim argumentimin e kriterëve të vendosura për çdo procedurë dhe në përputhje me tipologjinë e procedurës në zbatim të aktet ligjore e nënligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm konstatohet se, Komiteti i Monitorimit të Brendshëm për zbatimin e Strategjisë dhe Planin e Veprimit të Shkollës së Magjistraturës për periudhën afatmesme 2024-2028, nuk ka hartuar raportin e monitorimit për planin akademik 2023-2024, në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Shkollës dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 7, datë 25.03.2024 “Për miratimin e strategjisë afatmesme të Shkollës së Magjistraturës 2024-2028”, për planin akademik 2023-2024.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 91-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Komiteti i Monitorimit të Brendshëm të hartojë raportin e monitorimit për

Planin Akademik të vitit 2023–2024, duke u mbështetur në treguesit e përcaktuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit, të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 25.03.2024.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e komponentit “Mjedisi i Kontrollit”, rezultoi se ky komponent është vlerësuar me nivel të lartë nga menaxhimi, por pavarësisht kësaj, ky komponent ka nevojë të zhvillohet me tej, në drejtim të rritjes së nivelit të njohurive të stafit administrativ nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme të organizuara prej saj ose nga ASPA, lidhur me përditësimin e njohurive për shkak të ndryshimit të legjislacionit, si dhe rritjen e nivelit të njohurive të tyre për komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit kryesisht me vlerësimin e riskut; lidhur me procedurat e prokurimit publik, kryesisht për anëtarë të komisioneve të prokurimeve (i cili mungon si trajnim) apo trajnime mbi rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 91-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Drejtori dhe Kancelari i Shkollës së Magjistraturës të analizojnë nevojat për trajnime, duke anketuar stafin për fushat ku ndiejnë më së shumti nevojë për përmirësim të njohurive dhe aftësive. Të hartohet dhe zbatohet një plan trajnimi vjetor për stafin administrativ, i cili të përfshijë module mbi: Përditësimet e legjislacionit të zbatueshëm për administratën publike; komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit, me fokus të vlerësimit të riskut dhe proceset vendimmarrëse; procedurat e prokurimit publik, në veçanti për anëtarët e komisioneve të prokurimit, duke adresuar mungesën aktuale të trajnimeve në këtë drejtim.

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e komponentit “Menaxhimi i Riskut”, rezultoi se në kuadër të menaxhimit të riskut është hartuar Regjistri i Riskut, i cili është pjesë e paketës së diskutimeve gjatë hartimit të planeve vjetore të Shkollës së Magjistraturës dhe të hartimit të PBA-së. Për periudhën 2022-2024, SHM ka hartuar Regjistrin e Riskut për çdo vit buxhetor, pasi menaxhimi i riskut fillon me procesin e buxhetimit, për të siguruar lidhjen e buxhetit me realizimin e objektivave dhe matjen e performancës së aktiviteteve gjatë procesit të kontrollit për realizimin e tyre.

Por, pavarësisht vlerësimit të riskut në planifikim buxhetor afat mesëm dhe vjetor, zbatimi i strategjisë së menaxhimit të riskut, ka mos realizim sipas vlerësimit të riskut, me ndikim në mos realizim të plotë të orëve mësimore sipas programit mësimor të miratuar për çdo vit akademik, mos parashikim i saktë i fondeve buxhetore për pagat dhe sigurime shoqërore për stafin akademik me kohë të plotë, të pjesshëm, kandidatë për magjistratë, ndihmës ligjorë, etj., mos realizim i regjistrit të prokurimeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqe 91-104 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1.Rekomandimi: Kancelari të marrë masa për të përditësuar dhe përmirësuar Regjistrin e Riskut, duke përfshirë identifikimin e më shumë risqeve specifike dhe të mundshme për çdo sektor të veprimtarisë akademike dhe administrative të institucionit dhe të përditësohet rregullisht në përputhje me zhvillimet e reja.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve ekonomike konstatohet se, me Urdhër Shpenzimin nr. 232, datë 24.05.2024 është rimbursuar kosto e biletës së udhëtimit në *vlerën 680*

USD, bazuar në urdhrin nr. 112, datë 13.06.2024, të Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës “Për kompensimin e z. Adelajd Agron Tabaku lidhur me koston e biletës së udhëtimit për të marrë pjesë në provimin e pranimit”.

Urdhëruesi ka argumentuar se në këtë rast jemi para një përgjegjësie civile objektive dhe pa faj, bazuar në nenin 3, pika “ç”, të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësitë jashtë kontraktore të administratës shtetërore”, i ndryshuar.

Gjithashtu, argumentohet se për shkak të ndryshimit/shtyrjes së datës së fazës së dytë të provimit, janë cënuar pritshmëritë e ligjshme të konkurrenteve dhe bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (Vendimet nr. 9/2007; nr. 11/2007; nr. 10/2008) pritshmëritë e ligjshme përbëjnë një interes të ligjshëm, që meriton të njihet dhe të mbrohet.

Është vlerësuar se në rastin konkret jemi përpara një dëmi civil dhe përgjegjësie civile, e për rrjedhojë bazuar në nenin 19 të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, është urdhëruar kompensimi i biletës së udhëtimit të konkurrentit.

Nga auditimi referuar dispozitave ligjore mbi të cilin është kryer pagesa konstatohet se nuk kemi një definicion për “përgjegjësi civile edhe pa faj” sipas nenit 3, pika ç, e ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësitë jashtë kontraktor të administratës shtetërore”, i ndryshuar, dhe se referenca ligjore e cituar në vendimet e Gjykatës Kushtetuese është e përgjithshme dhe nuk përputhet me objektin e këtij shpenzimi të kryer lidhur me “pritshmëritë e ligjshme”, duke sjellë efekt negativ në buxhetin e Shkollës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtori dhe Kancelari i Shkollës së Magjistraturës për të shmangur raste të ngjashme të përdorimit pa efektivitet të fondeve publike, t’i drejtohen Ministrisë së Financave apo Këshillit të Ministrave, si organe kompetente për interpretimin e legjislacionit apo zgjidhjen e problematikave të cilat nuk parashikohen në dispozitat ligjore.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve ekonomike me thesarin konstatohet se nga SHM në disa raste janë kryer shërbime e pagesa duke u bazuar në VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar, nenin 5, pika 2, duke kryer prokurim të drejtpërdrejtë.

Konkretisht: Në vitin 2023 në 4 raste në shumën 199,000 lekë dhe në vitin 2024 në 6 raste në shumën 1,081,170 lekë, **gjithsej në shumën 1,280,170 lekë.**

Nga auditimi konstatohet se për kryerjen e këtyre shpenzimeve nuk ka dokumentacion të përlllogaritjes së fondit limit të tyre, me qëllim garantimin e kosto-efektivitetin e këtyre shërbimeve, në mospërputhje me kërkesat e VKM nr. 768, datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe të shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të veçanta, për të cilat mund të rezervohet e drejta e pjesëmarrjes së organizatave në procedurat e prokurimit publik, si dhe rregullave të detajuara për prokurimin e tyre”, i ndryshuar, neni 1, pika 1, pika 3, me nenin 5, pika 2, paragrafi 2, si dhe me nenin 1 të LPP, qëllimi i të cilit është të rrisë eficiencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje dhe me kërkesat e Rregullores “Për gjurmët e auditimit në Shkollën e Magjistraturës” KREU III.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 59-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Kancelari në bashkëpunim me Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të marrë masa për parashikimin e saktë dhe të plotë të nevojave për mallra e shërbime, argumentimin e saktë të fondit limit për shpenzimet për shërbime sociale dhe jo vetëm, me qëllim të mirë përdorimit të fondeve publike dhe eliminimit të efekteve negative në zhvillimin e procedurave të prokurimit, si dhe të nxisë pjesëmarrjen e konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë e të sigurojë transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në vijimësi

Në zbatim të nenit 15, shkronja (j), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe nisjen e procedurave disiplinore e administrative apo hartimin e padive gjyqësore për shpërblimin e demit dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (*me shkrim*) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të auditimit dhe rekomandimeve.

